



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 08.05.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 253, të datës 22.04.2015, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), Nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për formimin e 'Komisionit për Hartimin e Rregullores për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor' dhe 'Rregullores për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit', në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve:
 - 1.1 Sabit Bullatovci - Përfaqësues i LDK-së;
 - 1.2 Sazana Statovci - Përfaqësuese e LDK-së;
 - 1.3 Aida Alimi - Përfaqësuese e PDK-së;
 - 1.4 Trandolina Duli - Përfaqësuese e LVV-së;
 - 1.5 Fitore Simnica - Përfaqësuese e PD-së;
 - 1.6 Hasan Krasniqi - Përfaqësues i AAK-së;
 - 1.7 Nuriye Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - 1.8 Fatlum Berisha - Zyrtar i Rinisë dhe Sportit;
 - 1.9 Hasan Gjyrevci - Shef i Kuvendit dhe Komiteteve;
 - 1.10 Zoran Kitiç - Zyrtar i Kthimit dhe Riintegritimit;
 - 1.11 Vesa Ibrahim - Shoqëria Civile.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit është hartimi i 'Rregullores për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor' dhe 'Rregullores për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit', në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2010, për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të Veprimit Rinor në Kosovë dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2010, për punën vullnetare të të rinjve.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 08.05.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 249, të datës 21.04.2015, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 17, shkronja (h), Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 6, Nenin 7, Nenin 19, të 'Ligjit për arsimin dhe aftësimin për të rritur' Nr. 04/L-143 (Gazeta Zyrtare 02/2013), Nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ë), Nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për hapjen e linjës buxhetore në kategorinë ekonomike 11 për 'Rroga dhe paga'.
2. Mjetet financiare, në shumë të përgjithshme prej 13,634.00€, si të hyra vetjake në arsim, destinohen për pagesat e arsimtarëve dhe stafit arsimor që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimor, mbajtjen e provimeve nga mësimi joformal dhe alokohen në kategorinë ekonomike 11 në arsimin e mesëm si vijon: në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Teknike 'Minatori', kodi i programit Nr. 94231, shuma prej 2,648.92€, në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme 'Hoxhë Kadri Prishtina', kodi i programit Nr. 94232, shuma prej 6,134.62€ dhe në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme 'Hivzi Sulejmani', kodi i programit Nr. 94233, shuma prej 4,850.46€.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është në kompetencë të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit dhe Drejtorisë së Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së Arsimit dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi